



Pranimar / Dorezuar Primiheq/Predata Received/Delivary	27-09-2022	2	viti grad Vcat
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	2457/2022		113



Republika e Kosovës -
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.228/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.228/2022 të datës 14.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.04.2022 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.228/2022 e datës 27.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresa të lëndës ka qenë i punësuar në Komunën e Prizrenit, ndërsa me datë 06.01.2021 është pensionuar. Me datë 22.02.2022 ankuesi ka parashtruar kërkesë në Komunën e Prizrenit për kompensimin e tri (3) pagave mujore për shpërblimin jubilar si dhe tri (3) paga mujore me rastin e pensionimit duke iu referuar Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 14.02.2022 i ka kthyer ankuesit përgjigjen me arsyetimin se kërkesa e ankuesit do të aprovohet pjesërisht, respektivisht një (1) pagë përcjellëse me rasti e pensionimit do të kompensohet deri në muajin mars 2023.

Ankuesi kundër përgjigjes së Njesisë së Personelit të Komunës së Prizrenit të datës 14.02.2022, nëpërmjet postë ka parashtruar ankesë me datë 10.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa në Këshill është pranuar me datë 14.03.2022 dhe është protokolluar me numër 1320/2022.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 21.03.2022, me numër protokollit 1461/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Prizrenit, ndërsa me datën 13.04.2022 nëpërmjet e-maili i cili është protokolluar me numër protokollit 21289/2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prizrenit me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.03.2022 me numër protokollit 1320/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e Njesisë së Personelit të Komunës së Prizrenit e datës 14.02.2022; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prizrenit për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit i datës 05.01.2021; Kopjen e librezës së punës së ankuesit me numër:610728; Vërtetimin e Zyrës së Personelit i datës 10.03.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.03.2022; E-mailin e datës 13.04.2022 me përgjigjen në kërkesë së bashku me shkresa e lëndës; Akt emërimit të ankuesit i datës 04.01.2012; Kërkesën e ankuesit të datës 22.02.2022 me numër protokollit:05-120/27738 të parashtruar në Komunën e Prizrenit; E-mailin e datës 14.04.2022 dërguar nga Këshilli për menaxherin e Njesisë së Burimeve Njerëzore Komunës së Prizrenit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e *pabazuar*, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjes e ankesave bazuar në akt emërimit të datës 04.01.2012 ka konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Prizrenit, ndërsa sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit me numër:01-118-000414 ankuesi e ka arritur moshën e pensionimit me datë 05.01.2021 dhe të njëjtit i është përfunduar marrëdhënia e punës, ndërsa vendimi në fjalë ka përmbajtur edhe këshillën juridike, duke e udhëzuar ankuesin që në rast të pakënaqësisë me vendimin e datës 05.01.2021 të Kryetarit të Komunës ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa në kërkesën e përcjellur përmes e-mailit të datës 14.04.2022 nga Këshilli për Menaxherin e Personelit të Komunës së Prizrenit se kur ankuesi e ka pranuar vendimin e kryetarit të Komunës së Prizrenit të datës 05.01.2022, një kërkesë të tillë nuk i është përgjigjur pavarësisht që e-mailin e ka hapur.

Sipas shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se kërkesa e ankuesit e parashtruar në komunën e Prizrenit për kompensimin e tri (3) pagave mujore për shpërblimin jubilar si dhe tri (3) paga mujore me rastin e pensionimit duke iu referuar Ligjit Nr.03/L-212 të Punës e ka marrë vulën hyrëse me datë 22.02.2022 dhe numër 05-120-27738, ndërsa mbetet e paqartë se si Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 14.02.2022 iu është përgjigjur një kërkesë e cila sipas vulës hyrëse është konstatuar se e njëjta është pranuar me datë 22.02.2022 në Komunën e Prizrenit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 127 paragrafi 1 ka përcaktuar se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", ndërsa sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit me numër:01-118-000414 i datës 05.01.2021 sipas të cilit ankuesit me rastin e arritjes së moshës së pensionimit me datë 05.01.2021 i ka përfunduar marrëdhënia e punës në shërbimin civil e ka përmbajtur edhe këshillin juridike duke e udhëzuar ankuesin që në rast të pakënaqësisë me vendimin e datës 05.01.2021 të Kryetarit të Komunës ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj ankuesit ka filluar t'i rrjedh afati prej momentit të pranimit të vendimit respektivisht prej pranimit të pagës në muajin pasues

dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se kërkesë e ankuesit e parashtruar pas më shumë së një (1) viti në Komunën e Prizrenit është parashtruar në kundërshtim me afatet e përcaktuara ligjore dhe në kundërshtim edhe me këshillën juridike, dhe si e tillë ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.

Kolegji po ashtu, konstaton se përgjigja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit e datës 14.02.2022 është në kundërshtim me nenin 24 paragrafi i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative", pasi që është i njohur fakti se me rastin e pensionimit të ankuesit me datë 05.01.2021 i ka përfunduar marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, respektivisht i njëjti nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike brenda afateve kohore për të goditur aktin e fundit administrativ i cili ka pasur ndërlidhje me marrëdhënien e tij të punës, respektivisht Vendimin e kryetarit të Komunës së Prizrenit me numër:01-118-000414 i datës 05.01.2021.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Lënda me A.nr.228/2022

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

